PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E PSIKOLOGUT

viti shkollor 2026/2027

PLANI I PUNËS DHE DETYRAT E PUNËS SË PSIKOLOGUT NË SHKOLLË

Veprimtaritë aktuale burojnë nga detyrat e përgjithshme të punës dhe kompetencat specifike të psikologut si bashkëpunëtor profesional në shkollë, të cilat bazohen në parimin themelor të aktivizimit dhe avancimit të nxënësve sipas mundësive dhe aftësive të tyre, si kusht thelbësor për efikasitetin dhe organizimin e të gjithë veprimtarisë arsimore.

Qëllimi kryesor i psikologut në shkollë është të marrë pjesë në të gjitha format e punës edukative në shkollë dhe të arrijë bashkëpunim me organet drejtuese të shkollës, mësuesit, nxënësit dhe prindërit për realizimin me sukses të procesit edukativo-arsimor.

Detyrat e psikologut shkollor bazohen në pjesëmarrjen dhe realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- Pjesëmarrje në hartimin e Programit vjetor të shkollës në bashkëpunim me drejtorin dhe mësuesit;
- Hartimi i programit vetanak të punës;
- Monitorimi i punës së aktiveve profesionale dhe organizimi i bashkëpunimit me anëtarët e tyre;
- Vëzhgimi i orëve mësimore dhe dhënia e vlerësimit për realizimin e mësimit dhe suksesin e tij;
- Vëzhgim pedagogjik në veprimtaritë mësimore dhe jashtëshkollore në shkollë;
- Përgatitja e analizave dhe raporteve për suksesin dhe sjelljen e nxënësve për katër tremujorët;
- Ndjekja sistematike e suksesit dhe sjelljes së nxënësve gjatë gjithë vitit shkollor;
- Organizimi i punëtorive dhe ofrimi i ndihmës profesionale për mësimdhënësit në përgatitjen e planeve vjetore, tematike dhe ditore për mësimdhënie;
- Puna për zgjerimin dhe thellimin e njohurive pedagogjike dhe psikologjike të mësimdhënësve, prindërve dhe mjedisit më të gjerë shoqëror, si dhe zbatimi i tyre në punën edukative;
- Pjesëmarrja, planifikimi, koordinimi dhe drejtimi i zbatimit të formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërmjet prindërve, shkollës dhe nxënësve për zbatimin e komponentit arsimor në procesin mësimor;
- Ndihmë e menjëhershme në punën edukativo-arsimore me kategoritë e veçanta të nxënësve (me sukses të ulët, me numër të madh mungesash, nxënës problematikë, nxënës që kanë vështirësi personale, sociale dhe familjare që ndikojnë në suksesin e tyre në shkollë);
- Marrja e masave parandaluese të higjienës mentale dhe masave të tjera për parandalimin e sjelljeve të papërshtatshme dhe të papranueshme të nxënësve;
- Përmirësimi i marrëdhënieve nxënës–nxënës dhe nxënës–mësues, përdorimi i metodave dhe procedurave për koordinim me të gjithë faktorët në shkollë dhe institucionet përkatëse;
- Krijimi i kushteve optimale dhe të favorshme për zhvillimin profesional të nxënësve, duke e nxitur dhe ndjekur atë me zbatimin e njohurive dhe aftësive pedagogjike e psikologjike në procesin mësimor;
- Veprimtari kërkimore;
- Bashkëpunëtorët profesionalë, si dhe të gjitha subjektet e tjera të përfshira në procesin edukativo-arsimor, kanë fushat e tyre të veprimit.

Puna e psikologut shkollor është e ndarë në disa segmente, si më poshtë:

1. PLANIFIKIMI, PROGRAMIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1	Udhëzim në përgatitjen e planeve dhe programeve vjetore për punën e mësimdhënësve dhe për Këshillin arsimor	Gusht, shtator	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, mësimdhënësit
2	Konsultimet dhe pjesëmarrja në përgatitjen e programit vjetor të punës së shkollës	Gusht	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
3	Pjesëmarrja në përgatitjen e programit vjetor të aktiveve	Gusht	Përgjegjësit e aktiveve profesionale
4	Planifikimi në kohë i aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit	Gusht, shtator, gjatë vitit	Grupet e punës dhe ekipet
5	Hartimi i programit vetanak të punës	Gusht	Kolegët e shkollave të tjera
6	Përgatitja e raportit për gjysmëvjetorin e punës së shkollës dhe e raportit për fund të vitit të punës së shkollës	Janar – qershor	Drejtori, pedagogu, mësimdhënësit

2. MONITORIMI I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE NË SHKOLLË

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1	Formimi i paraleleve për klasat e para	Gusht, shtator	Drejtori, psikologu, pedagogu, mësimdhënësit
2	Përcjellja e rrethanave dhe kushteve për organizimin dhe zbatimin e mësimit	Shtator	Drejtori, psikologu, pedagogu, mësimdhënësit

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
3	Rishikimi i dokumentacionit pedagogjik	Gjatë vitit	Psikologu, pedagogu, mësimdhënësit
4	Vizita e orëve mësimore	Gjatë vitit	Drejtori, psikologu, pedagogu, mësimdhënësit
5	Vëzhgim mbi cilësinë e bashkëpunimit me prindërit	Gjatë vitit	Kujdestarët e klasave, psikologu, pedagogu
6	Përcjellja e realizimit të aktiviteteve jashtëmësimore	Gjatë vitit	Kujdestarët e klasave, psikologu, pedagogu

3. PUNË KËRKIMORE – ANALITIKE

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1	Përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, përpunimi i tyre dhe përgatitja e raporteve për arritjet, sjelljet/dhunën, mungesat dhe të dhëna të tjera të nxënësve sipas periudhave kohore të shkollës	Gjatë vitit	Shërbimi profesional
2	Analiza e suksesit të nxënësve që kalojnë nga mësimi klasor në mësimin lëndor (klasa V në klasën VI)	Maj	Shërbimi profesional, kujdestarët e klasave V dhe VI
3	Anketa e nxënësve të klasave VII dhe VIII për problemet aktuale të moshës së tyre	Gjatë vitit	Shërbimi profesional
4	Përgatitja e instrumenteve me kërkesë të mësimdhënësve për nevoja të ndryshme (teste, pyetësorë, fletë studimi etj.)	Gjatë vitit	Shërbimi profesional
5	Përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për orientimin profesional të nxënësve	Mars	Shërbimi profesional

4. PUNA ME MËSIMDHËNËSIT

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1	Ofrimi i ndihmës profesionale për mësimdhënësit fillestarë	Gjatë vitit (sipas nevojës)	Mësimdhënësit
2	Ofrimi i mbështetjes dhe trajnimit të mësimdhënësve për realizimin e integrimit ndëretnik në arsim	Gjatë vitit	Mësimdhënësit, psikologu, pedagogu, prindërit
3	Qasje më e shpejtë ndaj ndryshimeve në vlerësim	Në fillim të vitit shkollor, gjatë vitit	Mësimdhënësit
4	Përcjellja e vazhdimësisë, objektivitetit, korrektësisë dhe transparencës në vlerësim	Gjatë vitit	Drejtori, mësimdhënësit, nxënësit
5	Përcaktimi i cilësisë së monitorimit dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve	Nëntor – maj	Mësimdhënësit, nxënësit
6	Informimi për avancimin në mësimdhënie nga aspekti psikologjik	Gjatë vitit	Mësimdhënësit, psikologu, shërbimi profesional
7	Arsimim për shkathtësitë jetësore	Shtator, tetor	Mësimdhënësit klasorë
8	Biseda dhe zgjidhja e problemeve të caktuara (me nxënësit, disiplina, suksesi, sjellja etj.)	Gjatë vitit	Mësimdhënësit, nxënësit
9	Ndihma e mësimdhënësve në përgatitjen e testeve të njohurive, pyetësorëve etj.	Gjatë vitit	Mësimdhënësit
10	Përparimi i punës ekipore	Gjatë vitit	Mësimdhënësit
11	Ligjërata mbi orientimin profesional të nxënësve	Gjatë vitit	Shërbimi profesional

5. PUNA ME NXËNËS

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1	Përcjellja e përshtatjes së nxënësve të klasës së parë në shkollë	Gjatë vitit	Kujdestarët e klasave, mësimdhënësit, prindërit
2	Puna me nxënës problematikë	Gjatë vitit	Kujdestarët e klasave, mësimdhënësit, prindërit
3	Këshillim (punëtori) me nxënësit kur mësimdhënësit kanë nevojë në situata të ndryshme	Gjatë vitit	Mësimdhënësit, nxënësit, prindërit
4	Përmirësimi i sjelljes së nxënësve – marrja e masave përkatëse sipas rregullores së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës	Gjatë vitit	Kujdestarët e klasave, prindërit
5	Kujdesi për shëndetin mendor të nxënësve	Gjatë vitit	Mësimdhënësit, nxënësit, prindërit

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
6	Tejkalimi i vështirësive në përparimin e njohurive të nxënësve në procesin edukativo-arsimor	Tetor, nëntor	Kujdestarët e klasave, nxënësit
7	Ndihma e mësimdhënësit për të perceptuar shkaqet e sjelljes së papërshtatshme, propozimi i strategjive për ta kapërcyer atë dhe, së bashku me mësimdhënësin, ndjekja e efekteve të veprimeve të ndërmarra	Gjatë vitit	Nxënësit, parlamenti i nxënësve
8	Përkrahja e komunitetit (bashkësisë) të nxënësve në realizimin e projekteve për ekologji dhe integrim ndëretnik	Gjatë vitit	Nxënësit, parlamenti i nxënësve
9	Ligjëratë me temë "Bulizmi" – konfliktet mes nxënësve sipas rregullave të MASH për dhunën në shkolla	Shkurt	Shërbimi profesional
10	Zbulimi i sjelljeve antisociale te nxënësit dhe këshillimi individual dhe grupor për largimin e tyre	Gjatë vitit	Nxënësit, kujdestarët e klasave
11	Punë me kategori të veçanta nxënësish: – nxënës të talentuar dhe me dhunti; – nxënës me vështirësi në të nxënë; – nxënës me nevoja të veçanta arsimore (do të realizohet me bashkëpunimin e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve)	Gjatë vitit	Shërbimi profesional, mësimdhënësit, prindërit
12	Përgatitja e pyetësorit të anketës për të konfirmuar nëse dhuna ekziston dhe në çfarë mase është e pranishme te bashkëmoshatarët në shkollë: – zbatimi i anketës; – përpunimi i rezultateve; – përgatitja e raportit; – biseda dhe konsultime me mësimdhënësit lidhur me rezultatet e fituara	Gjatë vitit	Psikologu, nxënësit, kujdestarët e klasave

PUNË ME NXËNËS TË TALENTUAR DHE ME DHUNTI

Përmbajtja e programit – qëllimet e punës:

- aplikimi i procedurave metodologjike për njohjen dhe identifikimin e nxënësve të talentuar: vëzhgimi i proceseve që zhvillohen gjatë mësimit të përmbajtjeve të caktuara brenda ose jashtë shkollës; vëzhgimi i performancës ose i produkteve nga një fushë e caktuar; rezultatet e aplikimit të instrumenteve psikometrike; vetëvlerësimi i nxënësve potencialisht të talentuar, vlerësimi nga prindërit, mësimdhënësit dhe bashkëmoshatarët;
- planifikimi, zbatimi dhe vlerësimi i mësimdhënies së diferencuar;
- përgatitja e programeve për punë me nxënës me dhunti dhe të talentuar në lëndë të veçanta mësimore, planifikimi dhe realizimi i mësimit plotësues;
- mbajtja e evidencës – dosje pedagogjike për nxënësit;
- dhënia e mbështetjes për nxënësit dhe prindërit e tyre;
- zhvillimi profesional i mësimdhënësve;
- bashkëpunimi me komunitetin lokal, institucionet dhe shoqatat e specializuara.

PUNA ME NXËNËS ME NEVOJA TË VEÇANTA EDUKIMI

Përmbajtja e programit – qëllimet e punës:

- formimi i ekipit gjithëpërfshirës në shkollë, sipas Ligjit për arsimin fillor;
- analiza e situatës aktuale në shkollë, identifikimi i fëmijëve me vështirësi dhe nevoja për mbështetje, planifikim shtesë dhe realizim i mësimit plotësues;
- planifikimi, zbatimi dhe vlerësimi i mësimdhënies së diferencuar;
- funksionimi i ekipeve gjithëpërfshirëse për punë individuale me nxënësit, përgatitja dhe aplikimi i planit arsimor individual (PAI), monitorimi i realizimit të tij dhe vlerësimi;
- mbajtja e evidencës – dosje pedagogjike e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- dhënia e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe prindërit e tyre;
- zhvillimi profesional i mësimdhënësve;
- bashkëpunimi me komunën, institucionet dhe shoqatat e specializuara.

6. PROGRAM KËSHILLIMOR PËR PRINDËRIT/KUJDESTARËT E NXËNËSVE

Sipas Programit për këshillimin e prindërve/kujdestarëve të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme, këshillimi i prindërve ka dy qëllime themelore: (1) njohja e prindërve të nxënësve që nuk ndjekin rregullisht mësimin, kanë rënie të suksesit ose shfaqin sjellje të papërshtatshme, me natyrën dhe ashpërsinë e problemit që ka lindur te fëmijët e tyre; (2) edukimi i prindërve për mënyrat e përmirësimit të aftësive arsimore të fëmijëve dhe të marrëdhënieve familjare, në mënyrë që fëmijët e tyre të përballojnë më me sukses lloje të ndryshme vështirësish.

Prindërit/kujdestarët e nxënësit thirren për këshillim nëse nxënësi:

- e ndjek mësimin në mënyrë të parregullt për arsye të paarsyeshme, pra ka më shumë se 10 mungesa të pajustifikuara;
- ka performancë të pakënaqshme (tre ose më shumë nota të dobëta në fund të tre muajve ose gjysmëvjetorit);
- manifeston forma të ndryshme të sjelljes së papërshtatshme.

Krahas këshillimit të prindërve/kujdestarëve, si pjesë e domosdoshme e mbështetjes realizohet edhe këshillimi me fëmijët e tyre, pra me nxënësit. Psikologët ose pedagogët kryejnë këshillim me prindërit/kujdestarët nëse takimet e mëparshme të mësimdhënësve të klasës me prindërit nuk kanë çuar në zgjidhjen e situatës.

6. PUNA ME PRINDËRIT

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1	Ndarja e informacionit rreth të nxënit (mësimit) dhe sjelljes së nxënësit me prindërit në mënyrën e duhur	Gjatë vitit	Shërbimi profesional, mësimdhënësit
2	Informimi i prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore për të drejtat, detyrimet dhe përfitimet që mund të marrin dhe udhëzimi te institucionet përkatëse për ndihmë	Gjatë vitit	Shërbimi profesional, mësimdhënësit, prindërit
3	Realizimi i konsultimeve individuale me prindërit për të mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta arsimore	Gjatë vitit	Shërbimi profesional, mësimdhënësit
4	Organizimi dhe kryerja e këshillimit grupor dhe individual me prindërit e nxënësve që përballen me mossukses në mësim, me nxënës të parregullt dhe me nxënës me sjellje të papërshtatshme	Gjatë vitit	Shërbimi profesional, mësimdhënësit

PROGRAM PËR KËSHILLIM INDIVIDUAL DHE NË GRUPE TË PRINDËRVE

Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët	Format e punës	Burimet	Rezultatet e pritura
Këshillim në grup me prindër/kujdestarë të nxënësve me probleme në të nxënë, nxënës të parregullt dhe problematikë	Dhjetor, prill	Psikologu, drejtuesit e klasave	Biseda këshilluese me prindërit në takimet e prindërve dhe individuale	Drejtuesit e klasave, raportet	Përmirësimi i situatës aktuale
Këshillimi i nxënësve me probleme të të nxënit	Në vazhdimësi	Psikologu, drejtuesit e klasave	Këshillime, biseda	Raportet, të dhënat e nxënësve	Rritja e motivimit për sukses
Këshillim me nxënës jo të rregullt	Gjatë vitit	Psikologu, drejtuesit e klasave	Këshillime	Raporti, të dhënat e nxënësve	Përmirësimi i rregullsisë
Këshillim me nxënës problematikë	Gjatë vitit	Psikologu, drejtuesit e klasave	Këshillime	Procesverbali	Përmirësimi i situatës

7. PUNA ME ORGANE DHE TRUPA PROFESIONALË

Nr.	Përmbajtja	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1	Pjesëmarrja në punën e Këshillit arsimor dhe të klasave	Gjatë vitit	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
2	Pjesëmarrja në punën e aktiveve profesionale	Gjatë vitit	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
3	Pjesëmarrja në përgatitjen e PIA-së (plani individual i arsimit)	Gjatë vitit	Ekipi i përfshirjes, mësimdhënësit, prindërit

8. ORIENTIMI PROFESIONAL I NXËNËSVE

Bazuar në nenin 47, paragrafi (2) i Ligjit për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli **Programin orientues profesional për nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë të shkollave fillore**.

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të rrisë ndërgjegjësimin e nxënësve përmes pjesëmarrjes aktive në procedurën e modelit pesëfazor të orientimit profesional, të marrin përgjegjësi për të ardhmen e tyre, të njohin veten dhe aftësitë e tyre, rrugët arsimore dhe rrugët e karrierës, të informohen për botën e punës, të mendojnë me kujdes për vendimin e zgjedhjes së arsimit/profesionit dhe në këtë mënyrë të arrijnë sukses në planifikimin e karrierës.

Programi i orientimit profesional synon të krijojë aftësi vendimmarrëse te të rinjtë. Shkolla planifikon dhe ndërmerr aktivitete specifike për orientimin profesional të nxënësve. Qëllimi i të gjitha aktiviteteve është informimi dhe orientimi korrekt profesional i nxënësve, njohja e tyre me mundësitë që ofrojnë shkollat e mesme, strukturat dhe profesionet, informimi për kushtet dhe kriteret e regjistrimit në shkollën e mesme, zbulimi i interesave dhe dëshirave për vazhdimin e shkollimit, duke ofruar ndihmë për zgjedhjen e duhur të profesionit. Fusha e orientimit profesional të nxënësve është puna e vazhdueshme gjatë arsimit fillor dhe njohja e profesioneve, për t'i nxitur që të zgjedhin profesionin e ardhshëm.

Bashkëpunëtorët profesionistë bisedojnë me nxënësit për vazhdimin e shkollimit, përmes së cilës njihen me interesat dhe qëllimet e tyre, për krijimin e CV-ve, letrës motivuese dhe planit të zhvillimit të karrierës etj. Organizohen aktivitete që kanë të bëjnë me këshillimin për karrierë. Organizohen prezantime të profesioneve nga shkollat e mesme shtetërore dhe private të qytetit, përmes të cilave nxënësit njihen me kushtet dhe kriteret e regjistrimit në shkollën e mesme.

PROGRAM PËR ORIENTIM PROFESIONAL TË NXËNËSVE

Nr.	Aktivitetet	Koha e realizimit	Bashkëpunimi
1	Orientimi profesional – ligjërata dhe punëtori me nxënësit	Gjatë vitit	Nxënësit, psikologu
2	Pasqyrë e konkursit të aplikimit për shkollën e mesme	Mars – prill	Përfaqësues nga shkollat e mesme, profesorë, nxënës, shërbimi profesional
3	Bisedë me prindërit për orientimin profesional	Gjatë vitit	Prindërit, kujdestarët e klasave, shërbimi profesional
4	Prezantimi i rezultateve të fituara – intervistë me nxënësit. Këshillim individual dhe grupor për orientimin profesional dhe në karrierë të prindërve	Gjatë vitit	Nxënësit, kujdestarët e klasave, shërbimi profesional
5	Bisedë me nxënësit, diskutime, ide, drejtime	Gjatë vitit	Nxënësit, prindërit, kujdestarët e klasave, shërbimi profesional

9. PROTOKOLLI PËR PËRGJIGJE NDAJ DHUNËS NË SHKOLLA

Protokoll për mbrojtjen e nxënësve nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca në shkollë

Aktivitetet e ndërhyrjes. Për të planifikuar dhe zbatuar në mënyrën më të mirë ndërhyrjen për mbrojtjen e fëmijëve, është e nevojshme të merren parasysh kriteret e mëposhtme:

- nëse ka dhunë apo dyshime për dhunë;
- ku zhvillohet – në shkollë apo jashtë saj;
- kush janë pjesëmarrësit në dhunë, abuzuesit dhe neglizhenca;
- natyra dhe intensiteti i dhunës, abuzimit dhe neglizhencës.

Sipas vlerësimit të nivelit të rrezikut, merret vendim për mënyrën e reagimit: (1) çështja zgjidhet në shkollë; (2) çështja zgjidhet në shkollë në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse; (3) lënda i përcillet shërbimeve të tjera kompetente.

ÇDO PERSON ME NJOHURI PËR DHUNË, ABUZIM DHE NEGLIZHENCË DUHET TË PËRGJIGJET.

Hapat – rendi i procedurave në ndërhyrje. Hapat tregohen në lidhje me situatat e mëposhtme: në rastet e dhunës ose dyshimit se dhuna po ndodh **MES NXËNËSVE**; në rastet kur nxënësi është i ekspozuar ndaj dhunës ose ka dyshime për dhunë nga **NJË I RRITUR I PUNËSUAR** në shkollë; në rastet kur nxënësi është i ekspozuar ndaj dhunës ose ka dyshime për dhunë nga **NJË I RRITUR QË NUK ËSHTË I PUNËSUAR** në shkollë.

1. NDËRGJEGJËSIMI PËR DHUNËN – ZBULIMI është hapi i parë për të mbrojtur nxënësin nga dhuna. Kjo zakonisht bëhet në dy mënyra në shkollë: përmes vëzhgimit ose marrjes së informacionit se dhuna është në vazhdim; ose përmes dyshimit se dhuna po ndodh, bazuar në identifikimin e shenjave të jashtme ose sjelljeve specifike të nxënësit dhe familjes, ose në besimin e drejtpërdrejtë nga vetë nxënësi dhe/ose nga një person i tretë (bashkëmoshatar, prind, kujdestar).

2. NDËRPRERJA, NDALIMI I DHUNËS – çdo i rritur që ka dijeni për dhunën (mësuesi kujdestar, mësuesi, drejtuesi i departamentit, çdo punonjës i shkollës) është i detyruar të reagojë duke ndërprerë dhunën ose duke kërkuar ndihmë (nëse gjykon se nuk mund ta ndalojë vetë dhunën).

3. QETËSIMI I SITUATËS – nënkupton sigurimin e nxënësit, ndarjen, bisedën me pjesëmarrësit etj.

4. KONSULTIMET kryhen menjëherë pas shfaqjes së dyshimit dhe/ose pas marrjes së informacionit për dhunë. Konsultimet kryhen në shkollë me kolegët, me Ekipin e Mbrojtjes së Nxënësve nga Dhuna, me drejtorin, pedagogun dhe psikologun. Në varësi të kompleksitetit të situatës, konsultimet mund të kryhen edhe me shërbime jashtë shkollës: QPS, institucioni shëndetësor, MPB etj.

Konsultimet janë të rëndësishme për: të sqaruar rrethanat dhe për të analizuar faktet në mënyrën e duhur; të vlerësuar nivelin/shkallën e rrezikut; të bërë një plan mbrojtës; të shmangur konfuzionin dhe për të parandaluar aktivitetet e pakoordinuara, të cilat mund të çojnë në dhunë të përtërirë.

Në konsultim duhet: të bëhet një përshkrim i detajuar, objektiv, pa vlerësim dhe interpretim, duke u kujdesur për privatësinë e nxënësit dhe të pjesëmarrësve të tjerë në dhunë; të përcaktohen rolet, detyrat dhe përgjegjësitë; të merret vendim për mënyrën e reagimit dhe të monitorimit të efekteve të masave të marra.

E RËNDËSISHME: Gjatë konsultimeve me kolegët në shkollë apo jashtë saj, është e rëndësishme të respektohet parimi i konfidencialitetit, si dhe parimi i mbrojtjes së nxënësve.

Pas zbulimit të dhunës dhe konsultimit me profesionistët apo institucionet përkatëse, në varësi të ashpërsisë, mund të ndërmerren këto veprime: marrja e masave të nevojshme në nivel shkolle (informimi i prindërve për dhunën ose i një personi të besuar në rast dyshimi për dhunë në familje, marrëveshje për mbrojtjen e nxënësit); përfshirja e shërbimeve kompetente sipas nevojës (institucioni shëndetësor, MPB, QPS etj.). Dorëzimi i raportit pranë shërbimeve kompetente është përgjegjësi e drejtorit të shkollës. Raportimi bëhet në formë gojore dhe me shkrim.

E RËNDËSISHME: Nuk është detyrë e institucioneve arsimore të hetojnë dhe të provojnë abuzimin dhe neglizhencën. Këto detyra janë në kompetencë të shërbimeve të tjera.

Role dhe përgjegjësi për rastet me dhunë

Stafi drejtues:

- njohja me Protokollin për trajtimin e dhunës;
- përzgjedhja e anëtarëve në Ekipin për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna;
- pjesëmarrja e detyrueshme në procedurë kur bëhet fjalë për dhunën ndaj nxënësve;
- paraqitja e raporteve pranë institucioneve kompetente;
- monitorimi dhe vlerësimi i masave të marra për mbrojtjen e nxënësve përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me ekipin.

Anëtarët e ekipit:

- pjesëmarrja në trajnime për mbrojtjen e nxënësve nga dhuna;
- njohja e nxënësve dhe prindërve me Protokollin për mbrojtjen e nxënësve nga dhuna dhe abuzimi;
- koordinimi i zhvillimit dhe zbatimit të programit për mbrojtjen e nxënësve nga dhuna;
- organizimi i konsultimeve në shkollë dhe vlerësimi i nivelit të rrezikut për sigurinë nga dhuna;
- bashkëpunimi me institucionet përkatëse;
- regjistrimi i dukurive të dhunës.

Mësuesit e klasës:

- pjesëmarrja e detyrueshme në procedurë kur bëhet fjalë për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë apo nga punonjësit (ndalimi i dhunës ndërmjet nxënësve, qetësimi i situatës, mbledhja e informacionit, informimi i prindërve, marrëveshja për masat mbrojtëse, monitorimi i efekteve të masave të marra, monitorimi i sjelljes së nxënësve të mundshëm);
- mbajtja e detyrueshme e evidencës për shfaqjen e dhunës ndërmjet nxënësve;
- njohja e detyrueshme e nxënësve në orën e mësimit me rregulloren e shkollës, kodin e sjelljes së nxënësve, si dhe me protokollin;
- biseda me nxënësit e klasës dhe vlerësimi i nivelit të rrezikut të dhunës ndaj tyre.

Mësuesit në detyrë:

- njohja me Protokollin dhe detyrimet për pjesëmarrje në një ndërhyrje;
- pjesëmarrja e detyrueshme në procedurë kur bëhet fjalë për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë apo nga punonjësit (ndalimi i dhunës mes nxënësve, qetësimi i situatës, informimi i udhëheqësit të departamentit);
- mbajtja e detyrueshme e evidentimit të rasteve të dhunës në librin e evidencës së mësimdhënësit kujdestar.

Punonjësit e tjerë të shkollës:

- njohja me Protokollin dhe detyrimet për pjesëmarrje në një ndërhyrje;
- pjesëmarrja e detyrueshme në procedurë kur bëhet fjalë për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë apo nga punonjësit (ndalimi i dhunës ndërmjet nxënësve, qetësimi i situatës, informimi i përgjegjësit të departamentit).

Nxënësit:

- njohja me Protokollin dhe detyrimet për pjesëmarrje në një ndërhyrje;
- nxënësit kujdestarë informojnë mësuesin kujdestar për dhunën ndërmjet nxënësve në shkollë;
- komuniteti i klasës informon drejtuesin e klasës dhe mësuesin e lëndës në rast të dhunës në klasë.

POLITIKA E MBROJTJES SË FËMIJËVE

ShFK "Liria" Tetovë miratoi Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve me qëllim që të ofrojë udhëzime dhe masa të përshtatshme për mbrojtje nga shkeljet e të drejtave të fëmijëve në të gjitha nivelet gjatë punës së rregullt të shkollës. Politika përfshin përcaktimin e të drejtave të fëmijës për mbrojtje nga dhuna dhe abuzimi, një kod sjelljeje që lidhet me respektimin e të drejtave të fëmijës, si dhe një protokoll për trajtimin e rasteve të dhunës, së bashku me udhëzime, masa të propozuara dhe shtojca për zbatim në rastet e abuzimit me fëmijët.

Kjo politikë është përgatitur me mbështetjen e Koalicionit të Organizatave Rinore SEGA, në kuadër të projektit "Promovimi i një Mjedisi të Sigurt Shkollor", i mbështetur nga Fondacioni i Fëmijëve Pestaloci. Politika është në përputhje me Udhëzimet për procedurën e raportimit dhe mbrojtjes së nxënësit viktimë të çdo forme dhune, abuzimi dhe neglizhence, të lëshuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në këtë Politikë, ShFK "Liria" Tetovë angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nga abuzimi, dhuna dhe shfrytëzimi, bazuar në dokumentet ndërkombëtare përkatëse, përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, nga e cila Neni 19 i referohet mbrojtjes nga dhuna:

Neni 19. 1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura legjislative, administrative, sociale dhe arsimore për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, lëndimit ose abuzimit, neglizhencës ose trajtimit neglizhent, keqtrajtimit ose shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual, ndërsa është nën kujdesin e prindërve, kujdestarëve ligjorë ose çdo personi tjetër që ka kujdesin për fëmijën.

2. Masa të tilla mbrojtëse, kur është e përshtatshme, përfshijnë procedura efektive për krijimin e programeve sociale të mbrojtjes dhe mbështetjes së nevojshme për fëmijën dhe për ata që u është besuar kujdesi për fëmijën, si dhe forma të tjera të parandalimit, zbulimit, raportimit, gjurmimit, hetimit, veprimit dhe monitorimit të rasteve të keqtrajtimit të fëmijëve, siç përmenden këtu, dhe, kur është e përshtatshme, sjelljen e tyre para drejtësisë.

Shprehjet e përdorura në këtë dokument në gjininë gramatikore mashkullore janë neutrale dhe u referohen si personave meshkuj ashtu edhe femra.

Shkolla Fillore "Liria" Tetovë nuk do të pranojë abuzimin me fëmijët në asnjë formë dhe në këtë mënyrë konfirmon përgjegjësinë e saj për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në të gjitha fushat e punës. Prandaj, për sa i përket marrëdhënieve në të cilat ndodh abuzim ose dhunë, kjo politikë mbulon marrëdhëniet midis të rriturve dhe fëmijëve, si dhe midis fëmijëve.

Stafi i shkollës dhe personat e tjerë në kontakt me fëmijët gjithmonë do të:

- fuqizojnë fëmijët duke rritur ndërgjegjësimin e tyre për të drejtat e tyre dhe duke i mësuar rreth tyre;
- promovojnë një kulturë të hapur ku diskutohen çështje dhe probleme të ndryshme;
- organizojnë punëtori që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të fëmijëve për përcaktimin e sjelljes së pranueshme dhe të papranueshme të të rriturve dhe fëmijëve;
- diskutojnë hapur me fëmijët rreth kontakteve dhe marrëdhënieve të tyre të ndërsjella, si dhe me stafin dhe persona të tjerë;
- diskutojnë me fëmijët çështjet për të cilat ata shqetësohen dhe t'u shpjegojnë se si t'i shprehin shqetësimet e tyre;
- identifikojnë dhe shmangin situatat diskredituese dhe/ose të cenueshme që mund të çojnë në akuza;
- bëjnë fotografi të fëmijëve (foto, video etj.) vetëm kur është e justifikuar dhe kur fëmijët janë të veshur në mënyrë të përshtatshme, duke shmangur imazhet me përmbajtje seksualisht sugjestive. Prindërit/kujdestarët ligjorë dhe fëmija duhet të japin leje me shkrim për fotografim (Shtojca 7.1).

Personi i kontaktit për politikën e mbrojtjes së fëmijëve

Drejtori i Shkollës Fillore "Liria" Tetovë emëron një Person Kontakti për Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve me vendim zyrtar dhe ndarje të detyrave dhe përgjegjësive. Elvira Shaqiri, psikologe në ShFK "Liria" – Tetovë, është emëruar Person Kontakti për zbatimin e kësaj Politike.

Të dhënat e kontaktit: elvira_shaqiri@yahoo.com; es609388@schools.mk; 071-853-300; (044-335-583)

Ekipi i Mbrojtjes nga Dhuna

Shkolla krijon gjithashtu një "Ekip për Mbrojtjen nga Dhuna", i cili do të jetë i disponueshëm publikisht për të gjitha palët e interesuara në jetën shkollore. Ekipi mban takime të rregullta (çdo tremujor ose gjashtëmujor) për të koordinuar dhe ndarë informacion lidhur me klimën shkollore dhe ekzistencën e dhunës. Ekipi mban procesverbale të shkurtra të çdo takimi, të cilat janë të disponueshme në arkivat e shkollës.

Në vazhdim, ky dokument përcakton më konkretisht llojet e dhunës ndaj fëmijëve, si dhe masat për të vepruar në përputhje me Udhëzimet për procedurën e raportimit dhe mbrojtjes së nxënësit viktimë të çdo forme dhune, abuzimi dhe neglizhence, si dhe praktikat pozitive.

Kjo Politikë do të rishikohet çdo 4 vjet ose kur shfaqet nevoja për trajtimin e çështjeve shtesë. Rishikimi i radhës do të bëhet në gusht 2028.

PLANI MUJOR I PUNËS SË PSIKOLOGUT

GUSHT	
Përmbajtja e punës	**Bashkëpunëtorët**
Udhëzim në përgatitjen e planeve dhe programeve vjetore për punën e mësimdhënësve, të Këshillit arsimor dhe të Këshillit të prindërve	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
Konsultimet dhe pjesëmarrja në përgatitjen e programit vjetor të punës së shkollës	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu

SHTATOR	
Përmbajtja e punës	**Bashkëpunëtorët**
Udhëzim në përgatitjen e planeve dhe programeve vjetore për punën e mësimdhënësve dhe të këshillave, si Këshilli i prindërve	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
Planifikimi në kohë i aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
Ndjekja e rrethanave dhe kushteve për organizimin dhe zbatimin e mësimit	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
Edukimi për aftësitë e jetës	Mësimdhënësit e klasës
Përcjellja e përshtatjes së nxënësve të klasës së parë në shkollë	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
Punë udhëzuese-konsultative me mësimdhënësit gjatë planifikimit dhe përgatitjes së mësimdhënies	Psikologu, pedagogu, mësimdhënësit
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

TETOR

Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Përfshirja e nxënësve në vlerësim dhe vetëvlerësim	Nxënësit, kujdestarët e klasave
Punëtori – Dhuna	Psikologu
Përcjellja e përshtatjes dhe mbështetjes së nxënësve të klasave I dhe VI	Psikologu, mësimdhënësit
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

NËNTOR

Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Edukimi për shkathtësitë jetësore	Mësimdhënësit
Ligjëratë me rastin e Ditëve të Psikologjisë – Kujdesi për shëndetin mendor	Nxënësit, mësimdhënësit, shërbimi profesional
Pjesëmarrja në zhvillimin e një programi për punë me nxënës të talentuar dhe me dhunti	Nxënësit, mësimdhënësit, shërbimi profesional
Përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, përpunimi i tyre dhe përgatitja e raporteve–formularëve për sukses (për nxënësit me 3 e më shumë nota të dobëta, sjellje të papërshtatshme, mungesa dhe të dhëna të tjera sipas periudhave kohore në shkollë)	Psikologu, mësimdhënësit
Vizitë në orë	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu
Përgatitja e raporteve pas vizitës në orë	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

DHJETOR

Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Analiza e suksesit të nxënësve që kalojnë nga mësimi klasor në atë lëndor (V në VI)	Mësimdhënësit e klasës V, kujdestarët e klasave VI
Ndjekja e arritjeve të nxënësve me PIA	Psikologu, mësuesi special, drejtori
Këshillim në grup me prindër/kujdestarë të nxënësve me probleme në të nxënë (sukses të ulët), nxënës të parregullt dhe nxënës problematikë	Psikologu, kujdestari i klasës, punë në grup
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

JANAR

Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Bashkëpunimi me kujdestarët e klasave për nxënësit me nota të dobëta, parregullsi në shkollë dhe ata që shfaqin sjellje të papërshtatshme (biseda, diskutime në grup)	Mësimdhënësit, psikologu
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

SHKURT

Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Ligjëratë me temë "Bulizmi" – konfliktet mes nxënësve	Shërbimi profesional
Përgatitja e pyetësorit të anketës për të konfirmuar nëse dhuna ekziston dhe në çfarë mase është e pranishme te bashkëmoshatarët në shkollë: zbatimi i anketës; përpunimi i rezultateve; përgatitja e raportit; biseda dhe konsultime me mësuesit lidhur me rezultatet e arritura	Psikologu, nxënësit, kujdestarët e klasave
Ligjëratë mbi orientimin profesional të nxënësve	Shërbimi profesional
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

MARS

Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Diskutime individuale dhe në grup me nxënësit për ndërgjegjësimin dhe interesat e tyre për arsimim dhe punësim të mëtejshëm	Psikologu, mësimdhënësit
Ndjekja e orëve	Drejtori, ndihmësdrejtori, psikologu
Përgatitja e shënimeve për obligimet shkollore në vitin aktual dhe njoftimi i prindërve për regjistrimin dhe dokumentacionin e nevojshëm	Shërbimi profesional
Bisedë me mësuesit për plotësimin e dosjes profesionale	Mësimdhënësit
Përgatitja e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, përpunimi i tyre dhe përgatitja e raporteve–formularëve për sukses (për nxënësit me 3 e më shumë nota të dobëta, sjellje të papërshtatshme, mungesa dhe të dhëna të tjera sipas periudhave kohore në shkollë)	Psikologu, mësimdhënësit
Ligjëratë mbi orientimin profesional të nxënësve	Shërbimi profesional

Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

MAJ	
Përmbajtja e punës	**Bashkëpunëtorët**
Përgatitja e një analize-raporti pas vrojtimit të qëndrimeve për ndërgjegjësimin dhe orientimin profesional të nxënësve të klasës së nëntë	Psikologu
Regjistrimi i nxënësve të klasës së parë në shkollë	Shërbimi profesional
Intervistë me nxënës për regjistrim në arsimin e mesëm	Nxënësit, mësimdhënësit e klasës, shërbimi profesional
Bisedë me nxënësit	Nxënësit, mësimdhënësit e klasës, shërbimi profesional
Ndihma dhe organizimi i prezantimeve të profesioneve; prezantimi i raporteve dhe analizave mbi suksesin, rregullsinë dhe sjelljen e nxënësve pas përfundimit të periudhave të klasifikimit	Psikologu
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

QERSHOR	
Përmbajtja e punës	**Bashkëpunëtorët**
Analiza e suksesit të nxënësve që kalojnë nga mësimi klasor në mësimin lëndor (V në VI)	Mësimdhënësit e klasës V, kujdestarët e klasave VI
Ndjekja e suksesit, sjelljes dhe rregullsisë së nxënësve sipas paraleleve, lëndëve, gjinisë dhe përkatësisë etnike dhe përgatitja e raporteve dhe analizave	Psikologu, drejtori, ndihmësdrejtori, mësimdhënësit
Përgatitja e raportit mujor për punën vetanake	Psikologu

PROGRAM PËR KUJDESIN E SHËNDETIT MENTAL TË NXËNËSVE

Qëllimi: Ndërgjegjësimi për konceptin e shëndetit mendor, kujdesi ndaj shëndetit mendor, përballimi i situatave të caktuara dhe nxitja e ndjenjës së nevojës për ndihmë, përmirësimi i inteligjencës emocionale të nxënësve me mbështetjen e mësimdhënësve dhe prindërve.

Aktivitetet kushtuar kujdesit për shëndetin mendor të nxënësve do të realizohen gjatë vitit shkollor, në orë me bashkësinë e klasës, në kuadër të aktiviteteve të lira të nxënësve, punëtorive dhe formave të tjera. Do të realizohen ligjërata dhe biseda me bashkësinë e klasës, me bashkëpunëtorë profesionalë, kujdestarë të klasave (mësimdhënësit) dhe me profesionistë të jashtëm lidhur me shëndetin mendor dhe përmbajtje të tjera që ndërtojnë ndërgjegjësimin e nxënësve për mbrojtjen e shëndetit mendor.

AKTIVITETET PËR REALIZIMIN E QËLLIMEVE

Aktiviteti i planifikuar programor	Qëllimi i veprimtarisë	Realizuesit	Koha	Rezultatet dhe efektet e pritshme
Realizimi i një punëtorie psiko-edukative me mësimdhënës	Përmirësimi i shëndetit mendor dhe mirëqenies së fëmijëve	Bashkëpunëtorët profesionistë	Gjatë vitit	Zhvillimi i kompetencave dhe aftësive për të punuar me fëmijët dhe prindërit e tyre, duke respektuar të drejtën e interesit më të lartë të fëmijës
Zbatimi i një punëtorie psiko-edukative në klasa	Vetëdija dhe ndërgjegjësimi për tjetrin, si dhe përgjegjësia personale në vlerësimin e vetes dhe të tjetrit	Bashkëpunëtorët profesionistë, mësimdhënësit klasorë dhe lëndorë	Gjatë vitit shkollor	/
Shënimi i Ditës Botërore të Shëndetit Mendor	Njohja me kuptimin e shëndetit mendor	Bashkëpunëtorët profesionistë, mësimdhënësit klasorë dhe lëndorë, nxënësit	Tetor, nëntor	Forcimi i kompetencave personale (konteksti individual) dhe sociale (konteksti social) dhe sensibilizimi i mjedisit (mësuesit, prindërit etj.) për rëndësinë e promovimit të shëndetit mendor dhe kujdesit për mirëqenien psikologjike
Përvetësimi i aftësive për të përmirësuar inteligjencën emocionale	Ballafaqimi me situatat e konfliktit dhe kontrolli i emocioneve	Bashkëpunëtorët profesionistë	Nëntor, dhjetor	Përballimi i emocioneve në situata problematike, pranimi i ndjenjave negative dhe pozitive
Realizimi i një punëtorie psiko-edukative me prindërit e nxënësve	Përmirësimi i shëndetit mendor dhe mirëqenies së fëmijëve	Bashkëpunëtorët profesionistë	Shkurt, mars	Kujdesi për shëndetin mendor në kontekstin familjar, ndikimi i tij në rritjen e fëmijëve dhe përballimi i ndjenjave si prind kur fëmija gjendet në një situatë problematike

1. PLANIFIKIMI, PROGRAMIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS EDUKATIVE

- Pjesëmarrje aktive në planifikimin e punës së përgjithshme të shkollës;
- Drejtimi i punës së aktiveve;
- Pjesëmarrja në planifikimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve;
- Pasqyrë e plotë e numrit të nxënësve, suksesit dhe sjelljes;
- Planifikimi i programit vetanak të punës.

2. MONITORIMI I PUNËS EDUKATIVE NË SHKOLLË PËRMES AKTIVITETEVE TË MËPOSHTME

- Përcaktimi i mundësive dhe karakteristikave potenciale të personalitetit të nxënësit, që përcakton pjekurinë e fëmijëve për të filluar shkollën dhe vendosjen korrekte të nxënësve në klasa;
- Njohuri të plota në çdo kohë për të dhënat dhe dokumentacionin;
- Zbulon nxënësit me vështirësi në progres dhe ndihmon në punën me ta;
- Zbulon dhe ndihmon në punën me nxënësit me mundësi të mëdha për përparim dhe zhvillim më të shpejtë, duke drejtuar aftësitë e tyre;
- Punon në realizimin e anketave, testeve, bisedave dhe këshillimeve me nxënësit për orientim profesional;
- Për realizimin e këtyre aktiviteteve psikologu përdor metoda dhe teknika të ndryshme, në varësi të asaj që disponon shkolla;
- Monitoron ecurinë e nxënësve sipas aftësive dhe karakteristikave të personalitetit të tyre;
- Me rekomandimin e mësimdhënësve zbulon dhe punon me nxënësit që shfaqin sjellje jopërshtatëse, si mungesa të pajustifikuara ose të shpeshta, shtim i mungesave, pirje duhani, sjellje agresive, si dhe përcakton statusin sociometrik të nxënësve nëse lind nevoja.

3. PUNË KËSHILLIMORE-KONSULTATIVE

Ky lloj pune zbatohet në punën me nxënës, prindër dhe, nëse është e nevojshme, me mësimdhënës. Këshillimi kryhet me ftesë paraprake të prindit të fëmijës që tregon sukses të reduktuar, sjellje të papërshtatshme ose një numër më të madh mungesash. Këshillimi kryhet dy herë në një periudhë prej dy javësh ndërmjet dy seancave të këshillimit. Në punën me mësimdhënësit merr formën e bashkëpunimit lidhur me të gjitha problemet në shkollë që i referohen mbarëvajtjes së procesit arsimor. Këshillimi i prindërve do të bëhet sipas Rregullores së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. ZHVILLIMI I PËRGJITHSHËM PROFESIONAL I STAFIT ARSIMOR

- Bashkëpunimi me mësimdhënësit në përgatitjen e të gjitha llojeve të programeve të punës;
- Punon në përmirësimin e vlerësimit të njohurive të nxënësve, veçanërisht me klasat e para dhe të dyta;
- Përfshirja në ekipin gjithëpërfshirës të shkollës;
- Vëzhgim në realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Arritjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara zhvillimore.

5. MBAJTJA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT PEDAGOGJIK

- Vëzhgim mbi të dhënat dhe dokumentacionin pedagogjik të shkollës dhe stafit mësimor;
- Mbajtja e dosjes profesionale për të punësuarit (mësimdhënësit maqedonas; pjesën tjetër e mban pedagogu);
- Mbajtja e evidencës së procesverbaleve nga bisedat me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit;
- Mbajtja e evidencës personale dhe e dokumentacionit;
- Ditari kronologjik i punës me nxënës;
- Evidenca e konsultimeve (këshillimeve) të realizuara me prindërit;
- Evidenca për ndjekjen e arritjeve të nxënësve;
- Evidenca e vizitave në orë, seminare, trajnime, punëtori, orë të hapura etj.

6. PËRGATITJA E MATERIALEVE PROFESIONALE

Në varësi të nevojave, rezultateve dhe njohurive të fituara, përgatiten materiale me shkrim, të cilat më pas u prezantohen organeve profesionale të shkollës.

AKTIVITETET ZHVILLIMORE

Veprimtaritë zhvillimore në punën e psikologut janë në funksion të realizimit të detyrave dhe aktiviteteve zhvillimore të shkollës për vitin shkollor aktual dhe janë këto:

- Puna me mësuesit për planifikimin e vlerësimit, përzgjedhjen dhe përgatitjen e kritereve, metodave, teknikave dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve;
- Ndjekja, hulumtimi dhe vlerësimi i aplikimit të risive, i shkallës së përmirësimit të vazhdimësisë, objektivitetit, drejtësisë dhe transparencës në vlerësimin e arritjeve të nxënësve;
- Realizimi i seminareve;
- Kodi i etikës për vlerësimin e nxënësve dhe mësimdhënësve;
- Vëzhgim mbi cilësinë e përfshirjes së prindërve në procesin e vlerësimit;
- Mbështetje në aktivizimin e punës së komunitetit të nxënësve;

- Ngritja e motivimit për të mësuar përmes përfshirjes në procesin e vlerësimit;
- Punëtori, tribuna dhe debate me prindërit;
- Punë këshillimore-konsultative me të gjithë faktorët në shkollë, në të gjitha nivelet dhe marrëdhëniet;
- Mbështetje në punën me fëmijët e përfshirë në arsimin e rregullt;
- Asistencë në zhvillimin e planeve individuale të punës për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore.

FORMAT E PUNËS

- Individuale
- Punë ekipore
- Konsultime
- Grupore

BURIMET

- Materiale profesionale, të dhëna nga ditarët, të dhëna nga dokumentacioni ekzistues;
- Koncepti për arsimin fillor, raportet dhe programet vjetore, Ligji për arsimin fillor;
- Përgjegjësit e aktiveve profesionale;
- Materiale profesionale, njohuri nga konsultat, seminaret, literatura etj.;
- Literaturë profesionale;
- Ditarë pune, të dhëna nga raportet gjashtëmujore dhe vjetore nga mësuesit, programet e punës;
- Shënime nga regjistrimet, bisedat me prindërit dhe fëmijët.

EFEKTET E PRITSHME

- Efikasiteti, saktësia dhe afirmativiteti i punës së organeve profesionale;
- Efikasitet më i madh në operacione, përgatitje në kohë në fillim të vitit shkollor;
- Përmirësimi i planifikimit të mësimdhënësve;
- Monitorimi i suksesshëm i vlerësimit formativ dhe i nxënësve;
- Përgatitja e një programi më të përsosur;
- Pasqyrë e plotë e suksesit, sjelljes dhe numrit të nxënësve, si dhe pasqyrë e realizimit të planeve;
- Forcimi i bashkëpunimit me prindërit;
- Angazhim më i madh i nxënësve në aktivitetet jashtëshkollore;
- Efikasitet në monitorimin e vazhdueshëm të suksesit të nxënësve.

PËRPILUAR NGA PSIKOLOGU: ELVIRA SHAQIRI